



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Në bazë të nenit 13.7, 15.1, 16.2, 19.2 dhe 33 të Ligjit për planifikimin hapësinor nr. 2003/14, të datës 3.7.2003, dhe të nenit 16, par. 1, shkronja **b** dhe neni 32 të Statutit të Komunës së Prishtinës, të dt. 31.3.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 16.7.2008, merr

V E N D I M
PËR FILLIMIN E HARTIMIT TË PLANIT RREGULLUES
“VELLUSHA” NË PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për fillimin e hartimit të Planit rregullues “Vellusha” në Prishtinë.

Neni 2

Qëllimi i nxjerrjes së Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, është rregullimi i hapësirës dhe urbanizimi, sipas destinimeve të planifikuara me Planin strategjik-zhvillimi urban i Prishtinës, të miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës nr. 01-031-1231/1, të dt. 2.7.2004, brenda kufijve të përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi.

Neni 3

Me Planin rregullues, nga neni 1 i këtij Vendimi, do të përpunohet hapësira e territorit të qytetit të Prishtinës, e emërtuar “Vellusha”, e cila përkufizohet: në anën veriore me rrugën “Nazim Gafurri”, në lindje me rr. “1 Tetori”, në juglindje me rr. “Mustafë Hoxha” deri te pikëtakimi me rr. “Rrustem Hyseni”, në perëndim me rr “Zenel Salihu”, vazhdon në rrugën “Afrim Loxha”, ku përmbillet me rrugën “Nazim Gafurri”, dhe përfshin sipërfaqen prej 22 ha.

Kufijtë e përshkruar të hapësirës, nga al.1 e këtij neni, janë të paraqitur në pjesën grafike, e cila është pjesë përbërëse e këtij Vendimi.

Neni 4

Bartësi i detyrave programore dhe të hartimit të Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të përcaktohet përmes procedurës së tenderimit.

Drejtoritë tjera të Kuvendit të Komunës së Prishtinës, janë të obliguara që të sigurojnë dhe t'i dërgojnë shënimet e kërkuara nga Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të cilat konsiderohen se janë të nevojshme për hartimin e Planit rregullues sipas këtij Vendimi.

Neni 5

Mjetet financiare për hartimin e Planit rregullues, sipas këtij Vendimi, do të sigurohen nga buxheti i Komunës së Prishtinës.

Neni 6

Plani rregullues, sipas këtij Vendimi, do të miratohet me vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, si projektplan, në mënyrë që ai t'i nënshtrohet diskutimit publik para finalizimit dhe miratimit përfundimtar të tij.

Derisa të bëhet miratimi përfundimtar i Planit rregullues për hapësirën e përshkruar në nenin 3 të këtij Vendimi, kërkesat e qytetarëve për zhvillim të punimeve do të zgjidhen përmes dhënies së pëlqimit në lokacion, me mundësinë e inkorporimit të lokacionit përkatës në Planin rregullues të këtij kompleksi.

Neni 7

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Këshilli i Drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Neni 8

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01 Nr. 35-1015, më. 16.7.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof. dr. Isa Mustafa